



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

**SHPALLJE PËR LËVIZJEN PARALELE
DHE PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE
(Inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Vlorë)**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VII të VKM Nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar, Këshilli i Qarkut Vlorë shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive për 2 (dy) pozicione :

**Inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Vlorë,
kategoria IV, klasa IV –2**

**Lloji i diplomës “Shkenca në fushën e Ekonomisë/Gjeodezisë/Agronomisë”, niveli i
diplomës “Master Profesional”**

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil!

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:	9 DHJETOR 2025
Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL:	15 DHJETOR 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

Inspektori në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Vlorë është përgjegjës për:

Sigurimin, respektimin dhe zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në ushtrimin e funksioneve, detyrave, përgjegjësi dhe kompetencave që i jepen me këto akte si dhe zbatimin e procedurave administrative në mbrojtjen e tokës bujqësore si dhe përdorimin e saj të qëndrueshëm si strukturë shtetërore e ngritur për këtë qëllim.

Kryerjen e detyrave specifike për inspektorët, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për mbrojtjen e tokës bujqësore, dhe rehabilitimin e tokave të dëmtuara.

Zbatimin e detyrave me qëllim realizimin me cilësi të punës, bashkëpunimi me aktorët e tjerë institucionalë si Komisioni i Mbrojtjes së Tokës në qark, Komisioni Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës, Inspektoriati Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Zbatimi i Plan-Veprimit, për ushtrimin e kontrolleve metodike, të zakonshme që organizohen nga IMT. Ushtrimi i kontrolleve në gjithë territorin e Qarkut Vlorë së bashku me pjesën tjetër të strukturës në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” i ndryshuar dhe përgatitja e raporteve pas kontrolleve të ushtruara mbi masat për mbrojtjen e tokës bujqësore, dhe rehabilitimin e saj.

Marrjen pjesë në komisione apo grupe pune të ngritura me urdhër të Kryetarit/Drejtorit/Kryeinspektorit.

Kryerjen e detyrave të tjera përkatëse që i caktohen.

I LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon, kategoria IV;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:

- a – Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional” në “Shkenca në fushën e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

Ekonomisë/Gjeodezisë/Agronomisë” (Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë; Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi). **Preferohet, për shkak të detyrave dhe funksioneve të IMT-së, diploma “Agronom”, “Gjeodet”.**

b - Të kenë mbi 1 (një) vit përvojë pune në profesion në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura.

c-Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup .

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b - Kopje të diplomës (përfshirë diplomën Bachelor) e noterizuar. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

c - Kopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) e noterizuar;

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, Zyra e Sekretarisë/Protokoll – Arkivës brenda datës **09.12.2025, në adresë: Këshilli Qarkut Vlorë, Zyra e Burimeve Njerëzore, Pallati i Kulturës “Labëria”, Kati i III –të , Vlorë.**

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **11.12.2025**, Këshilli i Qarkut Vlorë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit të Këshillit të Qarkut Vlorë, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Këshilli i Qarkut Vlorë, nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligjin Nr. 9131 datë. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligjin Nr. 9367 dt. 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
- Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Ligjin Nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 8752, datë 26.03.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 121, datë 17.02.2011 “ Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna/Bashki”.
- VKM Nr. 80, datë 28.01.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore” i ndryshuar.

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- ☐ Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- ☐ Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- ☐ Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është, si më poshtë vijon:

- a) 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv;
- b) 60 pikë intervista me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Vlorë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Këshillit të Qarkut Vlorë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

2

PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende është vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Qarkut Vlorë.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil të cilët plotësojnë kërkesat e nenit 21 të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar:

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimi në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta si vijon:

- a – Të zotërojnë diplomë të nivelit “**Master Profesional**” në “**Shkenca në fushën e Ekonomisë/Gjeodezisë/Agronomisë**” (Edhe diploma e nivelit “*Bachelor*” duhet të jetë në të njëjtën fushë; Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

*pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi). **Preferohet, për shkak të detyrave dhe funksioneve të IMT-së, diploma “Agronom”, “Gjeodet”.***

b - Të kenë të paktën mbi 6 (gjashtë) muaj përvojë pune në profesion në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura.

c - Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b - Kopje të diplomës (përfshirë diplomën Bachelor) e noterizuar. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*

c - Kopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) e noterizuar;

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, Zyra e Sekretarisë/Protokoll – Arkivës brenda datës **15.12.2025** në adresë: Këshilli Qarkut Vlorë, Zyra e Burimeve Njerëzore, Pallati i Kulturës “Labëria”, Kati i III –të, Vlorë.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **26.12.2025**, Njësi e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Këshilli i Qarkut Vlorë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Këshilli Qarkut Vlorë, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Ligjin Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligjin Nr. 9131 datë. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligjin Nr. 9367 dt. 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
- Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Ligjin Nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 8752, datë 26.03.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 121, datë 17.02.2011 “ Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në Qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në Komuna/Bashki”.
- VKM Nr. 80, datë 28.01.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore” i ndryshuar.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionet;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- deri në **15 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar.
- b- deri në **60 pikë** për vlerësimin me shkrim.
- c- deri në **25 pikë** për Intervistën e strukturuar me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli Qarkut Vlorë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurimit, do të marrin informacion në faqen e Këshillit të Qarkut Vlorë për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Qarkut Vlorë duke filluar nga data **11.12.2025**.